



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RREGULLORE

PËR

**MASAT E SIGURISË QË DUHET TË MARRIN OPERATORËT
EKONOMIKË TË PËRFSHIRË NË VEPRIMTARITË E
PRODHIMIT, IMPORTIT, EKSPORTIT, TRANSITIT TË
ARTIKUJVE PIROTEKNIKË**

Miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes

Nr. 906, datë 20.6.2024

Neni 1

Objekti i rregullores

1. Kjo rregullore synon të përcaktojë normat e përgjithshme që kanë të bëjnë me masat e sigurisë që duhet të marrin operatorët ekonomikë të përfshirë në veprimtaritë e prodhimit, importit, eksportit, transitit të artikujve piroteknikë. Operatorët ekonomikë, në zbatim të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë” dhe të kësaj rregulloreje, duhet të marrin masat e nevojshme për hartimin e rregulloreve të veçanta për aktivitetin që ushtrojnë dhe implementimin me rigorozitet të masave të sigurisë gjatë prodhimit, importit, eksportit, transitit të artikujve piroteknikë.
2. Në zbatim të kësaj rregulloreje dhe në përputhje me pikën 2, të nenit 16, të ligjit 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”, operatorët ekonomikë hartojnë rregulloret e brendshme për veprimtarinë që ushtrojnë, në përputhje por pa u kufizuar me këtë rregullore të përgjithshme.

Neni 2

Prodhimi i artikujve piroteknikë

1. Prodhimi i artikujve piroteknikë realizohet nga operatorët ekonomikë në impiante industriale të licencuara nga struktura përgjegjëse/AKSHE në Ministrinë e Mbrojtjes.
2. Aktiviteti i operatorëve ekonomikë për prodhimin e artikujve piroteknikë zhvillohet në përputhje me kërkesat e ligjit 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”.
3. Impiantet, linjat e prodhimit, makineritë, pajisjet dhe teknologjia e aplikuar duhet të jenë të certifikuara për këto aktivitete.
4. Aktiviteti i prodhimit të artikujve piroteknikë zhvillohet në zona të miratuara jashtë zonave urbane, rrugëve të transportit rrugor e hekurudhor.
5. Distanca e zonave ku zhvillohet aktiviteti për prodhimin e artikujve piroteknikë nga zonat e banuara, rrugët e transportit automobilistik e hekurudhor përcaktohet sipas llojit të artikullit piroteknik që do të prodhohet, kapacitetit të prodhimit dhe magazinimit dhe teknologjia e zgjedhur.
6. Ndërtesat për prodhimin e artikujve piroteknikë duhet të jenë projektuar dhe ndërtuar sipas teknologjisë së prodhimit, llojit të artikullit piroteknik, kapaciteteve operacionale dhe shkallës së rrezikshmërisë të artikullit piroteknik.
7. Ndërtesat dhe linjat e prodhimit dhe magazinimit të lëndëve të para dhe artikujve piroteknikë duhet të jenë të pajisura me sisteme për mbrojtjen nga zjarri dhe shkarkimet atmosferike. Këto sisteme projektohen dhe ndërtohen nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.
8. Modelet e sistemeve për mbrojtjen nga zjarri dhe shkarkimeve atmosferike përcaktohen sipas llojit të artikullit piroteknik dhe llojeve të lëndëve të para që përdoren.
9. Linjat për prodhimin e artikujve piroteknikë duhet të jene të pajisura me sisteme dhe impiante për trajtimin e shkarkimeve industriale, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në lejen e mjedisit të lëshuar dhe miratuar nga strukturat përkatëse.

10. Subjektet që licencohen për prodhimin e artikujve piroteknikë duhet të kenë personel për prodhimin, menaxhimin dhe administrimin e artikujve piroteknikë që t'i përgjigjen strukturës së prodhimit të produktit kryesisht:
 - a) operator për prodhimin me arsim të mesëm të përgjithshëm ose profesional mbi 18 vjeç dhe të trajnuar para fillimit të punës;
 - b) supervizor për prodhimin;
 - c) drejtues teknik;
 - ç) operator për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi;
 - d) operator për mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve.
11. Punonjësit e angazhuar për nevojat e operatorit ekonomik, të plotësojnë kushtet e aftësisë shëndetësor, trajnimit sipas kërkesave të nenit 13, të ligjit 74/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë për përdorim civil”.
12. Operatorët që punojnë në linjat dhe impiantet e prodhimit të artikujve piroteknikë duhet të pajisen me mjete mbrojtëse, si: rroba pune, maska, doreza sipas operacioneve të procesit të prodhimit.
13. Personeli përgjegjës për magazinimin, asgjësimin e artikujve piroteknikë duhet të jetë i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nga organi përgjegjës në ministrinë që mbulon fushën e industrisë dhe të energjetikës.

Neni 3

Importi, eksporti, transiti i artikujve piroteknikë

1. Importi, eksporti, transiti i artikujve piroteknikë realizohet nga operatorët ekonomikë të licencuar nga struktura përgjegjëse/AKSHE, në Ministrinë e Mbrojtjes.
2. Aktiviteti i operatorëve ekonomikë për import, eksport, transit të artikujve piroteknikë zhvillohet në përputhje me kërkesat e ligjit 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”.
3. Punonjësit e angazhuar për nevojat e operatorit ekonomik të plotësojnë kushtet e aftësisë shëndetësor, trajnimit sipas kërkesave të ligjit 74/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”.
4. Personeli përgjegjës për magazinimin, asgjësimin e artikujve piroteknikë duhet të jetë i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nga organi përgjegjës në ministrinë që mbulon fushën e industrisë dhe të energjetikës.
5. Transiti i artikujve piroteknikë kryhet me automjetet e posaçme. Automjeti që kryen transportin, të jetë i pajisur me certifikatë “ADR”, sipas ligjit “Për transportin e lëndëve të rrezikshme”.
6. Drejtuesi i automjetit që kryen transportin, të jetë i pajisur me certifikatë “ADR”, sipas legjislacionit në fuqi “Për transportin e lëndëve të rrezikshme”.
7. Në bazë të autorizimit të transimit, operatori ekonomik duhet të përcaktojë itinerarin e lëvizjes, pikat doganore hyrëse dhe dalëse, si dhe kohën e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4

Masat kryesore të sigurisë

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së importit, eksportit, prodhimit dhe transitit të artikujve piroteknikë, operatorët ekonomikë duhet të marrin të gjitha masat e sigurisë për mbrojtjen e jetës, shëndetit të njerëzve, mjedisin, si dhe pronën.
2. Masat e sigurisë për çdo aktivitet duhet të përcaktohen në rregulloret përkatëse të sigurimit teknik të miratuar nga administratori dhe drejtuesi teknik i operatorit ekonomik.
3. Rregullorja e Sigurimit Teknik e operatorit ekonomik duhet të sigurojë dhe të mbulojë kushtet e punës, pajisjet dhe sisteme të sigurta për të gjithë punonjësit e saj brenda kufijve të territorit të ushtrimit të veprimtarisë. Kjo rregullore duhet të shtrijë masat e sigurisë edhe për shëndetin jetën e njerëzve pronës jashtë territorit ku ka ndikim ushtrimi i veprimtarisë së operatorit ekonomik.
4. Administratori i operatorit ekonomik dhe drejtuesi teknik është përgjegjës për çështjet e sigurimit dhe shëndetit, por megjithatë përgjegjësia për sigurimin dhe shëndetin shtrihet në të gjitha hallkat e menaxhimit deri te çdo individ punonjës.
5. Në rregulloren e sigurimit teknik, operatori ekonomik duhet të ketë të përcaktuara rregulla të qarta mbi:
 - a) **Kontrollin:** Të gjitha magazinat, pajisjet dhe proceset e punës duhet t'i nënshtrohen niveleve të caktuara të kontrollit për të garantuar përputhjen e tyre me standardet e kërkuara të sigurimit dhe shëndetit;
 - b) **Informimin:** Të gjithë punonjësit duhet të mbahen të informuar në lidhje me çështjet e sigurimit dhe shëndetit nëpërmjet shenjave dhe njoftimeve paralajmëruese, trajnimeve dhe rregulloreve e procedurave. Të gjitha aktivitetet në lidhje me artikujt piroteknikë do të drejtohen me anë të rregulloreve dhe procedurave të përgatitura nën përgjegjësinë e administratorit të operatorit ekonomik dhe drejtuesit teknik;
 - c) **Trajnimin:** Të gjithë punonjësit duhet të marrin trajnimin e duhur në mënyrë që ata të jenë të aftë për të bërë punën e tyre, në përputhje me procedurat e miratuara për shëndetin dhe sigurimin, si dhe me rregulloret e operatorit ekonomik;
 - ç) **Mbikëqyrjen:** Niveli i mbikëqyrjes duhet të jetë në përshtatje me aktivitetin, eksperiencën dhe njohuritë e atyre që janë të përfshirë në këtë aktivitet. Mbikëqyrja e procesit bëhet nga supervizori i repartit, operatorët, drejtuesi teknik dhe përgjegjësi për sigurinë;
 - d) **Mbrojtjen:** Sigurimin e veshjeve dhe/ose pajisjeve të përshtatshme në mënyrë që të zvogëlohet ose eliminohet krijimi i gjendjeve të pafavorshme në lidhje me shëndetin dhe sigurimin;
 - dh) **Raportimin:** Raportimi i menjëhershëm i incidenteve dhe aksidenteve në lidhje me shëndetin dhe sigurimin për përmirësimin e standardeve për shëndetin dhe sigurimin. Në veçanti, duhet të raportohen të gjitha aksidentet në lidhje me pajisjet, magazinat dhe proceset e punës që përfshijnë artikujt piroteknikë;
 - e) **Hetimet:** Hetimet në lidhje me incidentet dhe aksidentet për të marrë masat e duhura parandaluese dhe korrigjuese, si dhe për të bërë ndryshimet e nevojshme të rregulloreve dhe procedurave;

ë) Sigurimin ndaj zjarrit dhe procedurat e emergjencës: Veprimet e menjëhershme që duhen marrë në rast zjarri, duhet të ekspozohen në mënyrë të dukshme në të gjitha vendet e punës;

f) Aksidentet dhe procedurat mjekësore: Veprimet që duhen marrë në rast aksidentesh duhet të ekspozohen në mënyrë të dukshme në të gjitha vendet e punës;

g) Sigurimi elektrik: Të gjitha pajisjet elektrike duhet të kontrollohen dhe të testohen rregullisht nga përdoruesit për të verifikuar ndonjë dëmtim të mundshëm dhe që nuk ka shenja të dukshme të ndonjë problemi. Pajisjet elektrike dhe sistemet e furnizimit me energji i nënshtrohen mirëmbajtjes periodike sipas instruksionit të përdorimit nga specialistët për këtë qëllim;

gj) Materialet dhe pajisjet: Punonjësve u duhen dhënë udhëzimet e caktuara për rrezikun e pranishëm nga çdo pajisje ose material dhe i duhet bërë një trajnim në lidhje me përdorimin korrekt të tyre.

6. Operatori ekonomik duhet të hartojë rregulla të qarta për administrimin e artikujve piroteknikë, dhe magazinimin e tyre në depot e miratuara për këtë qëllim.
7. Magazinat ku ruhen artikujt piroteknikë u besohen personave që kanë njohuri për natyrën e secilës lëndë që ka në administrim.
8. Të gjithë llojet e artikujve piroteknikë duhet të përdoren, të ruhen e të magazinohen me kujdesin më të madh, në mënyrë të tillë që të mënjanohet çdo përplasje, goditje, gërvishtje, shtypje, zvarritje, rrokullisje, fërkim ose nxehje.
9. Magazinat nuk duhet të kenë lagështirë, të mos pikojnë, të mos mbulohen me materiale të djegshme, të jenë të ajrosura mirë, të mbahen pastër, të ruhen nga ndikimi i acideve dhe i alkoolëve.
10. Territori i magazinave ku ruhen artikujt piroteknikë duhet të jetë i pastër, me rrugë kalimi të shtruara mirë për qarkullimin e sigurt të automjeteve e të makinës zjarrfikëse.
11. Pranë çdo magazine të ketë sheshe për të manovruar lirisht për kthimin e automjeteve.
12. Të kontrollohet në mënyrë periodike gjendja dhe gatishmëria e instalimeve elektrike, rezervuarëve dhe hidrantëve të ujit në territorin dhe në magazinat e artikujve piroteknikë.
13. I gjithë personeli që merret me ruajtjen, administrimin dhe magazinimin e artikujve piroteknikë të pajisen me dëshmi zjarrmëtarë e çdo muaj të bëhet instruktimi i tyre nga ana e përgjegjësve përkatës.
14. Magazinierët kryejnë kontrollin e gjendjes teknike të artikujve piroteknikë, në mënyrë periodike. Për çdo rast konstatimi të prishjes (ose dyshim) së artikullit piroteknik, merren masa për vendosjen e tij në një depo të veçantë e njoftohen menjëherë drejtuesit.
15. Operatori ekonomik duhet të hartojë dhe miratojë rregulla të veçanta për hyrjen në territorin e magazinave ku ruhen artikujt piroteknikë, si dhe për sistemin dhe ruajtjen e tyre.

Neni 5

Hartimi i procedurave në rastet e emergjencës dhe trajtimi i aksidenteve

1. Mundësia e një aksidenti shkaktuar nga eksplozivët nuk mund të eliminohet plotësisht, prandaj është thelbësore që ndërtesat që trajtojnë aksidentet të mbahen në një gjendje të vazhdueshme gatishmërie dhe që procedurat e emergjencës të kuptohen nga i gjithë personeli dhe të testohen rregullisht.

2. Marrja e masave të emergjencës përfshin, por nuk kufizohet në:

- a) pajisjen e ndërtesës me zjarrfikëse, sisteme kundër zjarrit;
- b) përgatitjen e ndërtesës për ndihmën e shpejtë dhe evakuimin mjekësor;
- c) krijimin e lidhjes së ngushtë të shërbimit civil dhe atij të zjarrfikësve, policisë, ambulancës dhe spitalit. Të përgatiten procedurat e veprimeve të përbashkëta, të cilat duhet të ushtrohen çdo vit;
- ç) përgatitjen dhe ushtrimin e një plani evakuimi për personelin;
- d) sigurimin e një sistemi alarmi që mund të dëgjohet në të gjithë zonën. Ky sistem duhet të testohet minimumi çdo javë.

3. Operatorët ekonomikë duhet të miratojnë një rregullore të përgjithshme që të përmbajë planin e veprimit dhe procedurat në rastet e emergjencës dhe trajtimit të aksidenteve. Me këto masa duhet të njihen të gjithë personat që kryejnë punë me artikuj piroteknikë.

Neni 6

Para lëshimit të licencave të importit, eksportit ose prodhimit, si dhe gjatë vlefshmërisë së licencave, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, rast pas rasti, propozon të caktohen ekspertë të fushës nga Forcat e Armatosura për verifikimin e kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe me të njihen strukturat shtetërore të cilat kanë kompetenca mbi administrimin e artikujve piroteknikë, sipas përcaktimeve të ligjit 74/2021, i ndryshuar, si dhe operatorët ekonomikë që kanë aktivitet në fushën e artikujve piroteknikë.